

Manifest për një ardhmëri të përbashkët



Ne, të nënshkruarit këtu, konstatojmë:

Se në të gjitha kohërat ka pasur ikje dhe migrim, se Zvicra qe 150 vjet një vend imigrimi është dhe se nuk do t'ia dalë ta ndrydhë imigrimin me kontigjentim e as me represion.

Se migrimi kontribuon në zgjerimin e mirëkuptimit kulturor dhe se është shansë për krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe më paqësore- jo vetëm në suazat nationale, por në mbarë botën.

Se Zvicra nuk ka llogari ta ndrydhë imigrimin, sepse pa të nuk do të kishte zhvillim ekonomik, siguri sociale, pasuri kulturore dhe mirëqenje.

Se pa kryerjen e punëve në amvisni nga ana e migranteve, integrimi i grave zvicerane në tregun e punës nuk do të ishte fare i mundshëm.

Se Zvicra megjithate po përpiqet të aplikojë një ligj më të rreptë për të huajt dhe të ashpërsojë të drejtën për azil si dhe jetën tonë private dhe familjare t'ia nënshtrorë një mbikqyrjeje të rreptë policore.

Sa fyerje dhe ofendime kanë duruar migrantët dhe refugjatët gjer tani, në këtë vend! Votimet e panumërta të iniciativave raciste dhe kundër të huajve i kanë lënduar ata pa masë! As ashpërsimi i ligjeve nuk do ta pengojë migrimin, por do të shkaktojë më shumë dhembje, padrejtësi, tregëti me njerëz dhe skllavëri moderne.

Ne jemi të bindur se migracioni është njëra nga sfidat e mëdha të ardhmërisë. Një të ardhme normale do ta kemi vetëm nëse kësaj sfide i çasemi së bashku me resurset tona të shumfishta.

Ne, migrantet, migrantët dhe refugjatët në Zvicër, do të japim edhe më tutje kontributin tonë ekonomik, social, politik dhe kulturor. Cfarë do të ndodhte nëse, vetëm për një ditë, do ta ndalnim këtë kontribut? A do ecnin trenat, a do zhdukeshin plehrat, a do punonin makinat? A do shtroheshin shtretërit në hotele, a do servoheshin shujtat, a do shërbeheshin myshterijntë, a do kishin përkujdesje të sëmurët, a do vazhdonin projektet shkencore, a do pastroheshin banesat dhe rrugët; a do luhej në binat e teatrit dhe në fushat e futbollit? Ne i ftojme të gjitha migrantet dhe të gjithë migrantët që, të angazhohen aktivisht për çështjet që trajton ky manifest dhe të koordinojnë aktivitetet me organizatat e migrantëve, ndërmjet vete si dhe me organizatat përparimtare zvicerane. Edhe ne do e themi fjalën tonë dhe me aksione publike do të bëjmë presion për realizimin e propozimeve tona: **Pa ne s'bën.**

Unterzeichnende

19.12.2003

ACOR SOS Racisme
AMIKA – Arbeitsgruppe
Migration Integration Kommunikation
Antonio Hautle, Dir. Fastenopfer
AsF, Amitié sans frontières
Asylgruppe Schaffhausen
Basler Gewerkschaftsbund
BastA! Basel
Beratungsstelle Türkei, Basel
Berner Frauenhaus
C.E.D.R.I.
CASA, Centre de l'Alliance Suisse-Afrique
CCA Centre Culture Anatolie Lausanne
CCSI Genève et Fribourg,
Centre de Contact Suisse(sse)s-Immigré(e)s
Centre social protestant – La Fraternité
CETIM Centre Europe – Tiers Monde
cfd – Christlicher Friedensdienst
Circolo Culturale Realtà Nuova
Circolo di Zurigo di Rifundazione Comunista
Collectif de soutien aux Sans-papiers de Genève
collectif sans-papiers, la côte
comedia-Migrationskommission /
Commission des migrations de comedia
Comité Jurassien de Soutien aux Sans Papiers
Comité sans-papiers Fribourg
Les communistes, Genève
CTSSL collectif des travailleuses/eurs sans statut légal de Genève
Democratici di Sinistra in Svizzera
DIDF Demokratik Isci Dernekleri Federationu
DJS-JDS, Demokratische Juristinnen und Juristen Schweiz /
Juristes Démocrates de Suisse
En quatre ans on prend racines
Erklärung von Bern, deutsche Schweiz
Europäisches BürgerInnenforum / Forum Civique Européen
FAMI Fachstelle Migration der Ref. Kirchen Bern-Jura-Solothurn /
Service Migration des Eglises réformées Berne-Jura-Soleure
FCLIS Federazione Colonia Libere Italiane in Svizzera
FIZ Fraueninformationszentrum für Frauen aus Afrika,
Asien, Lateinamerika und Osteuropa
FIM-Schweiz Forum für die Integration der MigrantInnen /
Forum pour l'intégration des migrant(e)s
Flüchtlingsgruppe Dreifaltigkeit, Bern
Forum gegen Rassismus / Forum contre le racisme
Frauengruppe SAFT, Basel
Frauen-Nottelefon Winterthur
Frauenrat für Aussenpolitik
Freiplatzaktion für Asylsuchende Basel
Freundeskreis Cornelius Koch /
Cercle d'amis Cornelius Koch
GBI-Migration und Integration /
SIB-Migration et Intégration /
SEI-Migrazione e integrazione
Gewerkschaft Erziehung Basel
Gewerkschaftsbund Baselland
Groupe de migration
du Syndicat SIB-Genève
Grüne / Les Verts / I Verdi
Grüne Stadt u. Kanton Zürich
HEKS-Komitee Bern /
EPER Comité Berne
IG Secondas

IGA Solothurn –
SOS Racisme

IGA Interprofessionelle
Gewerkschaft der
ArbeiterInnen, Basel

Interessengemeinschaft Binational
I-ÖDK, Isvicere Özgürlük ve
Dayanisma Kordinasyonu,
Koordination für Freiheit und Solidarität

isa, Informationsstelle für Ausländerinnen-
und Ausländerfragen, Bern

ITAL-UIL

JungsozialistInnen Schweiz /
Jeunesse Socialiste Suisse

Komitee Sans-Papiers Nordwestschweiz

KUTÜSCH
Kurdischer-Türkischer-Schweizerischer Kulturverein

l'autre syndicat, Nyon

Les Casse-rôles, collectif féministe lausannois

L'Italia dei Valori

MERS, Menschenrechte Schweiz /
Association suisse pour les droits de la personne

MigrantinnenRaum, Aargau

Netzwerk Secondo

Neue PdA, Basel

OeME (Oekumene, Mission und Entwicklungs-zusammenarbeit)
der Ref. Kirchen Bern-Jura-Solothurn /
Eglises réformées Berne-Jura-Soleure, Secteur OeTN-Migrations
Partei der Arbeit PdA / Parti suisse du Travail (PsT/POP)

PFG, Politische Frauengruppe St. Gallen

Plate-forme pour une table ronde sur les sans-papiers /
Plattform Runder Tisch zu den Sans-papiers

Reto Moritzi, Fachstellenleiter für fremdsprachige Kinder und
kulturelle Vielfalt

Rajo– Neue Hoffnung für Somalia

SAH Schweizerisches Arbeiterhilfswerk /
OSEO oeuvre suisse d'entraide ouvrière

Sankofa Plattform für Menschen Afrikanischen Erbes

Sans-Papiers-Kollektiv Bern

Scambio Fest der MigrantInnen und SchweizerInnen

Schweizerischer Friedensrat

SGA Sozialistisch Grüne Alternative

SGB-Migrationskommission /
USS Commission des migrations /
USS Commissione migrazione

SGK Stiftung Gertrud Kurz

SIT Syndicat interprofessionnel des travailleurs et travailleuses

SMUV-FTMH-FLMO

Solidaritätsnetz Region Basel

Solidaritätsnetz Sans-papiers Region Bern

Solidarité sans frontières

SOS Asile, Vaud

SP, Sozialdemokratische Partei Schweiz /
PS, Parti socialiste suisse /
Partito socialista svizzero

SP-Migration des Kantons Zürich

Toleranz95

Verein Integrationsnetz Zug

vpod schweiz / ssp suisse

Zürcher Freiplatzaktion
für Asylsuchende

Unterzeichnende

Të drejta politike dhe jo vetëm detyrime!

Të gjithë njerëzit do të duhej që, atje ku jetojnë dhe paguajnë tatimet, të mund të bashkëvendosin në politikë-pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare të fituar përmes lindjes apo me natyralizim (marrje të nënshtetësisë). Dinjiteti njerëzor, të drejtat e njeriut dhe të drejtat politike janë të pandara, prandaj do të duhej të vlejnjë për të gjithë njerëzit që jetojnë në Zvicër. Aty ku ka barazi për të gjithë, nuk nevoitet polici e veçantë kundër të „huajve“.

Ligje mbi bazën e të drejtave të njeriut

Ligjet nuk duhet që edhe më tutje të bazohen mbi parimin e frikësimit dhe represionit, por mbi obligimin që del nga e drejta ndërkombëtare, parimet humanitare, respekti dhe solidariteti:

- As qytetarët e BE-së e as ata nga vendet jashtë BE-së nuk duhet diskriminuar. Nuk duhet të ketë më kategori të migrantëve me të drejta të ndryshme.
- Duhet të nxirret një ligj i azilit, i cili nuk mëton frikësimin, por që bazohet mbi parimin e mbrojtjes dhe që azilkërkuesve ua njeh të drejtën për jetë dinjitoze dhe në siguri.
- Lejet e qëndrimit nuk duhet të kushtëzohen më me qëllime e arësytetime të ndryshme.
- Personave pa dokumente („Sans Papiers“) duhet t'u rregullohet qëndrimi në mënyrë kolektive.

Punë dhe paga korrekte

Migrantët nuk duhet edhe më tutje të diskriminohen në punë: në konkurrimin për punë, në paga, në arëhimin e mëtejme, në mundësitë e ngritjes profesionale e as në kushtet e punës. Kundër „Dumping-ut“ social dhe në paga duhet të zgjerohen urgjentisht kontratat e përgjithshme të punës. Migrantëve nuk duhet t'u kufizohet e drejta në mobilitet dhe duhet t'u garantohet e drejta e zgjedhjes së lirë të profesionit dhe të punëdhënësit.

Gjasët e barabarta për të gjithë fëmijët

Shumgjuhësia e fëmijëve të migrantëve dhe refugjatëve është një resurs i rëndësishëm kulturor dhe ekonomik, nëse kultivohet dhe akceptohet. Shkolla duhet të ballafaqohet me këtë sfidë dhe ta tejkalojë diskriminimin në bazë të prejardhjes gjeografike dhe përkatësisë sociale.

Migracioni nuk është katastrofë natyrore

Zvicra duhet, sa më parë t'i ratifikojë: Kartën e OKB-së mbi migracionin e punës, Kartën sociale të Europës si dhe disa marrëveshje të tjera të rëndësishme ndërkombëtare. Dhe, Zvicra duhet t'i zgjerojë programet e kooperimit dhe të ndihmës në zhvillim. Sot, dërgesat e parave të migrantëve në vendet e prejardhjes i tejkalon shumfishë kontributet e ndihmës zvicerane në zhvillim.

Meqë lëvizjet migruese shtohen me rritjen e pabarazive ekonomike, sociale dhe politike, të luftojmë për një botë në të cilën të gjithë njerëzit mund të jetojnë me dinjitet dhe në liri. Atëherë nuk do të duhet folur shumë për migracionin: shumë njerëz kanë dëshirë ta shohin botën, por vetëm pak sish rrijnë vullnetarisht tërë jetën në dhë të huaj.

www.ohneuns.ch

pa
ne
s'bën.

Po ta kishim ne migrante dhe migrantët një kanton

Kushtetuta e re zvicerane u garanton të gjithë njerëzve barazinë para drejtësisë: „Askush nuk guxon të diskriminohet, veçanërisht jo për shkak të prejardhjes, rasës, gjinisë, moshës, gjuhës, pozitës sociale, mënyrës së jetesës, bindjeve religjioze, politike dhe ideologjike apo për shkak të të metave fizike, shpirtërore apo psiqike“ (atikulli 8 neni 2). Megjithatë, në Zvicër jetojnë 1,5 milion njerëz të cilët diskriminohen për shkak të prejardhjes së tyre: Ne, migrantet dhe migrantët

Për ne vlenë edhe më tutje ajo që pat shkruar shkrimtari i madh zviceran Max Frisch më 1965: „Një popull i vogël zotërinjesh ndjehet i rrezikuar: Ka kërkuar fuqi punëtore, po i vijnë njerëz“. Lëvizja e pavarësisë në Amerikë ka sjellur një parim të famshëm, i cili në Zvicër gjer sot ka mbetur i panjohur: „No taxation without representation“. Kush paguan tatime, duhet ta ketë të drejtën për bashkëvendosje në çështjet politike me ndikim në jetën e tij.

Ne migrantët në Zvicër paguajmë 15 miliardë franga në vit tatime dhe 6 miliardë franga në vit kontribute për sigurimet sociale. Por, ne nuk kemi të drejtë të veprimit politik.

Po ta krijonin ata 1,5 milion migrantë dhe refugjatë të Zvicrës së bashku një kanton, ai do të ishte kantoni më i madh në Zvicër. Ne do të përfaqësoheshim nga 46 deputete dhe deputetë në këshillin nacional (Nationalrat), nga 2 deputete dhe deputetë në këshillin e kantoneve(Ständerat) dhe, mesatarisht nga një anëtar në këshillin federal (Bundesrat). Ne jemi të bindur se:

Asnjë kanton nuk do të mund të sillte dije më të gjithanshme në parlament dhe më shumë përvojë jetësore në debatë.